



YOUTH ASSOCIATION FOR HUMAN RIGHTS
ASOCIACIONI RINOR PËR DREJTAT E NJERIUT

Raport Monitorues

mbi punën e legjislativit
të Komunës së Lipjanit

2025

Janar - Qershor

COPYRIGHT © 2025. Youth Association for Human Rights (YAHR).

Youth Association for Human Rights i ka të rezervuara të gjitha të drejtat për këtë raport dhe asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të jetë objekt i riprodhimit ose bartjes në asnjë formë mekanike ose elektronike, duke përfshirë fotokopjimin ose ndonjë sistem të ruajtjes ose tërheqjes së materialeve pa autorizimin paraprak të botuesit me shkrim. Publikimi mund të riprodhohet ose të bartet vetëm për qëllime jo komerciale. Kurdo dhe kushdo që ka për qëllim të përdorë fragmente ose materiale të ndryshme të këtij publikimi, është i detyruar ta tregojë qartë burimin sa herë që janë nxjerrë fragmentet ose materialet e përdorura. Nëse keni ndonjë koment, kritikë ose sugjerim, ju lutemi na kontaktoni përmes ndonjë prej opsioneve të mëposhtme:

Adresa: Rruga Tahir Sinani,
14000, Lipjan,
Kosovë
Tel .: +383 (0) 44 786 414
E-mail: info.yahr@gmail.com
Web:www.yahr-ks.org

Autor: Bekim Krasniqi

Asistentë të hulumtimit: Bekim Krasniqi
Faqosja dhe dizajni: YAHR

Ky publikim është përgatitur nga Youth Association for Human Rights dhe përkrahur nga granti të Olof Palme International Center. Mendimet, përfundimet dhe konkludimet apo rekomandimet e shprehura këtu janë të Autorit(ëve) dhe jo medoemos pasqyrojnë qëndrimet e Olof Palme International Center"

TABELA E PËRMBAJTJES

Lista e shkurtesave	3
Lista e Tableave	3
Hyrje	4
Përmbledhje ekzekutive	5
Qëllimet e monitorimi të punës së Kuvendeve Komunale	7
Dinamika e punës së Kuvendit të Komunës së Lipjanit	8
Lista e rregulloreve dhe planeve të shqyrtuara nga Kuvendi komunal të vitit 2023:	10
Lista e raporteve të shqyrtuara nga Kuvendi komunal të vitit 2023:	10
Lista e vendimeve komunale të miratuar gjatë periudhës Janar - Qershor 2025:	10
Pyetje parlamentare	16
Inicimi i çështjeve	18
Burimet:	20

LISTA E SHKURTESAVE

AAK	ALEANCA PËR ARDHMËRINË E KOSOVËS
AKR	ALEANCA KOSOVA E RE
DCC	DEMOKRTASKA STRANKA
LB	LËVIZJA PËR BASHKIM
LDD	ALEANCA KOSOVA E RE
LDK	LIDHJA DEMOKRATIKE E KOSOVËS
LVV	LËVIZJA VETËVENDOSJE
KK	KUVENDI KOMUNAL
PAI	PARTIA ASHKALIVE PËR INTEGRIM
PD	PARTIA E DREJTËSISË
PDAK	PARTIA DEMOKRATIKE E ASHKALIVE TË KOSOVËS
PDK	PARTIA DEMOKRATIKE E KOSOVËS
PLE	PARTIA LIBERALE EGJIPTIANE
PSD	PARTIA SOCIAL DEMOKRATE
Yahr	YOUTH ASSOCIATION FOR HUMAN RIGHTS

LISTA E TABLEAVE

Tabela 1: Aktiviteti i Kuvendet gjatë 2023	6
Tabela 2: Renditja e Kuvendareve bazuar në angazhimet e tyre nëpër seanca plenare të Kuvendit të Lipjanit	8
Tabela 3: Pjesëmarrja e subjekteve politike gjatë seancave plenare në Kuvendin e Komunës së Lipjanit	11
Tabela 4: Pjesëmarrja e Kuvendareve gjatë seancave plenare në Kuvendin e Komunës së Lipjanit	12
Tabela 5: Pjesëmarrja e subjekteve politike në pyetjeve parlamentare në Kuvendin e Komunës së Lipjanit	13
Tabela 6: Pjesëmarrja e subjekteve politike në Inicimi i çështjeve në Kuvendin e Komunës së Lipjanit	

HYRJE

Në gjysmën e parë të vitit 2025, **Youth Association for Human Rights (YAHR)** ka monitoruar dhe vlerësuar performancën e Kuvendit të Komunës së Lipjanit, duke u përqendruar kryesisht në iniciativat dhe çështjet që janë ngritur nga subjektet politike. Inicimi i çështjeve është një prej mekanizmave më të rëndësishëm që kanë kuvendarët për të adresuar problemet dhe nevojat e qytetarëve. Ai ka një ndikim të drejtpërdrejtë në përmirësimin e kushteve të jetesës, zhvillimin e projekteve komunale dhe përforcimin e llogaridhënies nga ana e ekzekutivit.

Në këtë periudhë monitorimi, YAHR ka ndjekur me kujdes aktivitetet e Kuvendit të Komunës së Lipjanit, për të ofruar një pasqyrë të detajuar mbi pjesëmarrjen e subjekteve politike në ngritjen e çështjeve të rëndësishme dhe diskutimin e tyre gjatë seancave plenare. Ky proces është një nga mënyrat më të drejtpërdrejta për të vlerësuar angazhimin e përfaqësuesve të qytetarëve dhe gatishmërinë e tyre për të adresuar shqetësimet e komunitetit, duke promovuar transparencën dhe përgjegjshmërinë.

Raporti i paraqitur pasqyron se si secili subjekt politik ka kontribuar në këtë proces, duke ngritur çështje që prekin jetën e qytetarëve dhe që janë të rëndësishme për zhvillimin dhe përparimin e komunës. Gjatë këtij monitorimi, janë analizuar dhe krahasuar iniciativat e subjekteve politike, duke nxjerrë në pah cilat kanë qenë më të angazhuarat dhe cilat kanë mbetur pasive në këtë drejtim.

Në përfundim të këtij raporti, ne shpresojmë që ky informacion të shërbejë si një udhëzues i dobishëm për qytetarët e Komunës së Lipjanit, për të pasur një pasqyrë më të qartë mbi punën e Kuvendit dhe performancën e përfaqësuesve të tyre. Një Kuvend më i angazhuar dhe më transparent është thelbësor për forcimin e demokracisë lokale dhe për arritjen e një qeverisjeje më të mirë për të gjithë qytetarët.

Me respekt,

Bekim Krasniqi

Drejtor Ekzekutiv i YAHR-it

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Në gjysmën e parë të vitit 2025, **Youth Association for Human Rights (YAHR)** ka monitoruar intensivisht punën e legjislativit të Komunës së Lipjanit. Ky monitorim është bërë me qëllim përmirësimin e performancës së kuvendarëve komunal si përfaqësues të qytetarëve. Ky raport përmbledh një analizë të hollësishme mbi aktivitetin dhe angazhimin e kuvendarëve gjatë seancave plenare, inicimin e çështjeve, dhe pyetjeve drejtuar ekzekutivit, duke ofruar një pasqyrë të qartë mbi angazhimin e secilit kuvendar.

Kuvendarët më Aktivë: Përkushtimi në Pjesëmarrjen dhe Iniciativat

Nga 6 seancat plenare të monitoruara, janë vlerësuar me nota të larta kuvendarët që kanë kontribuar në diskutime dhe kanë ngritur çështje për të përmirësuar situatën e qytetarëve të Lipjanit. Në krye të renditjes për performancë gjatë kësaj periudhe janë:

- **Arsim Jashari (PDK)** – 155 pikë
- **Lumturije Bytyqi Hasani (PDK)** – 104 pikë
- **Rinor Murati (LDK)** – 101 pikë

Ky trio u dallua për pjesëmarrjen aktive në diskutime, ngritjen e çështjeve dhe përkrahjen e pyetjeve për ekzekutivin. Pjesëmarrja e tyre ka kontribuar në një përmirësim të perceptimit të Kuvendit si një organ të angazhuar dhe të përgjegjshëm ndaj qytetarëve.

Një vëmendje speciale meritojnë edhe **tre kuvendarët gra më aktive** gjatë kësaj periudhe, të cilat treguan angazhim të shkëlqyer:

- **Lumturije Bytyqi Hasani (PDK)** – 104 pikë
- **Shahadije Dragacina (LVV)** – 87 pikë
- **Egzona Bytyqi (PDK)** – 75 pikë

Pjesëmarrja e grave në diskutime dhe nisma tregon një progres të dukshëm në përfshirjen e tyre në vendimmarrje dhe përfaqësim të interesave të qytetarëve.

Kuvendarët më Pasivë: Mungesa e Angazhimit

Në anën tjetër, disa kuvendarë kanë pasur një angazhim shumë të ulët, duke mos kontribuar fare në seancat plenare ose në inicimin e çështjeve për diskutim. Kuvendarët që nuk morën asnjë pikë gjatë këtij periudhe janë:

- **Shefki Bytyqi, Majlinda Sylejmani, Xhyla Dedushaj Rexhepi, Sami Bytyqi, Fitim Shala nga LDK-ja, Fatmir Fetahu (LVV) dhe Enver Kryeziu (PAI)**

Kjo mungesë e angazhimit ka krijuar një hendek në përfaqësimin e qytetarëve dhe vë në dukje nevojën për të rritur përgjegjësinë dhe aktivizmin e këtyre individëve në strukturat e Kuvendit.

Aktiviteti i Subjekteve Politike: PDK dhe LVV Dominon

Në analizën e aktiviteteve të grupeve parlamentare, për partitë politike opozitare, si zakonisht, pati një angazhim më të madh se ato në pushtet.

PDK udhëhoqi me **38 diskutime**, ose **43.18%** të totalit të diskutimeve. **LVV** pasoi me **27 diskutime** (30.68%), dhe **LDK** kishte **23 diskutime** (26.14%). Nga ana tjetër, **AAK** dhe **PAI** nuk patën asnjë diskutim, duke theksuar një mungesë të angazhimit nga këto subjekte.

Në lidhje me inicimin e çështjeve, **PDK** ishte gjithashtu më e angazhuara, duke ngritur **57 çështje** (55.34%). **LDK** nisi **23 çështje** (22.33%), ndërsa **LVV 20 çështje** (19.42%). Përsëri, **AAK** dhe **PAI** nuk ngacmuan asnjë çështje, duke e lënë këtë hapësirë për partitë e tjera.


Pjesëmarrja në Pyetje Parlamentare: Mbajtja e Ekzekutivit Përgjegjës

Sa i përket pyetjeve parlamentare drejtuar ekzekutivit, **PDK** u rendit e para me **14 pyetje** (45.16%). **LVV** kishte **11 pyetje** (35.48%), dhe **LDK** kishte **6 pyetje** (19.35%). Këto pyetje janë një mjet i rëndësishëm për të siguruar që ekzekutivi të mbajë llogari për veprimet dhe politikat e tij, dhe pjesëmarrja aktive në këtë proces është një tregues i angazhimit për të mbrojtur interesat e qytetarëve.

Tabela 1. Aktiviteti i Kuvendeve Komunave gjatë periudhës Janar - Qershor 2025

Komuna	Nr. i vendimeve të aprovuara	Nr. i raporteve / informata të shqyrtuara	Nr. i Rregulloreve të miratuara
<i>Lipjan</i>	31	4	0

Aktiviteti i Kuvendit Komunal të Lipjanit gjatë periudhës së parë të vitit 2025



QËLLIMET E MONITORIMI TË PUNËS SË KUVENDEVE KOMUNALE

Qëllimet e monitorimit të punës së kuvendeve komunale nga organizata shoqërore Youth Association for Human Rights (YAHR) kanë një ndikim të rëndësishëm në përmirësimin e përgjegjshmërisë dhe transparencës së proceseve vendimmarrëse në nivel lokal. Këto qëllime përfshijnë:

1. **Adresimi i interesave dhe brengave të qytetarëve:** YAHR synon të përfaqësojë dhe të adresojë interesat e përgjithshme të qytetarëve të Lipjanit në mënyrë të paanshme dhe jo-partiake. Përmes monitorimit të punës së kuvendarëve komunalë, organizata punon për të siguruar që çështjet e rëndësishme për komunitetin të trajtohen dhe të diskutohen në mënyrë transparente dhe në përputhje me nevojat e qytetarëve.
2. **Ofrimi i informacionit të vazhdueshëm:** YAHR angazhohet të sigurojë që qytetarët të kenë qasje në informacionin e plotë dhe të rregullt lidhur me punën dhe vendimet e Kuvendit Komunal të Lipjanit. Kjo përfshin monitorimin e seancave plenare, diskutimet, vendimet e miratuara, si dhe çështjet e ngritura dhe pyetjet e drejtuar drejtuesve ekzekutiv.
3. **Ndërtimi i shoqërisë së qëndrueshme demokratike:** Qëllimi kryesor i monitorimit të punës së kuvendeve komunale është të kontribuojë në forcimin e sistemit demokratik në Kosovë, duke promovuar llogaridhënien, transparencën dhe pjesëmarrjen e qytetarëve në proceset vendimmarrëse. Përmes vlerësimit të performancës së kuvendarëve, YAHR synon të inkurajojë

një mjedis ku përgjegjshmëria dhe integriteti janë vlera themelore të administratës publike lokale.

Këto qëllime përbëjnë një pjesë të strategjisë së YAHR për të siguruar që institucionet lokale të qeverisjes funksionojnë në mënyrë të përshtatshme dhe të përmbushin standardet e përgjegjshmërisë publike, duke i bërë ato më të qasshme dhe të përgjegjshme ndaj komunitetit lokal.

DINAMIKA E PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË LIPJANIT

Në gjysmën e parë të vitit 2025, Kuvendi i Komunës së Lipjanit ka pasur një angazhim të ndryshëm nga ana e kuvendarëve, ku disa janë treguar të jashtëzakonshëm në pjesëmarrjen dhe iniciativat e tyre, ndërsa disa të tjerë kanë mbetur të pasivizuar, duke lënë pas mundësitë për zhvillim dhe përmirësim të performancës së Kuvendit.

Kuvendarët më Aktivë: Liderët e Diskutimeve dhe Iniciativave

Dinamika e punës së Kuvendit të Komunës së Lipjanit është karakterizuar nga një angazhim i fortë i disa kuvendarëve që kanë shfaqur përkushtim të dukshëm ndaj qytetarëve dhe kanë kontribuar në proceset vendimmarrëse. **Arsim Jashari** nga **PDK** është renditur i pari me **155 pikë**, duke treguar një angazhim të jashtëzakonshëm në diskutime dhe iniciativat e tij. Pas tij renditet **Lumturije Bytyqi Hasani** (PDK) me **104 pikë**, dhe **Rinor Murati** (LDK) me **101 pikë**.

Alban Salihu (LVV) dhe **Shahadije Dragacina** (LVV) gjithashtu janë dalluar për pjesëmarrjen e tyre aktive, duke fituar **91 pikë** dhe **87 pikë** përkatësisht. Ata u bënë një zë i rëndësishëm në Kuvendin e Komunës, duke ngritur çështje dhe kontribuar në diskutime të ndryshme që prekin jetën e përditshme të qytetarëve të Lipjanit.

Disa kuvendarë të tjerë, si **Lulzim Rustemi** (PDK) dhe **Egzona Bytyqi** (PDK), gjithashtu kanë shfaqur angazhim të lartë, me **86 pikë** dhe **75 pikë** përkatësisht, duke pasur një ndikim pozitiv në seancat dhe diskutimet e Kuvendit. Këta individë, së bashku me të tjerë, janë bërë liderë të natyrshëm të debatit dhe të zhvillimit të çështjeve me interes për qytetarët.

Kuvendarët më Pasivë: Mungesa e Pjesëmarrjes dhe Angazhimit

Në anën tjetër, disa kuvendarë nuk kanë pasur asnjë angazhim të dukshëm gjatë periudhës gjashtëmujori të vitit 2025. Kuvendarët **Shefki Bytyqi**, **Majlinda Sylejmani**, **Xhyla Dedushaj Rexhepi**, **Sami Bytyqi**, dhe **Fitim Shala** (nga **LDK**), si dhe **Fatmir Fetahu** (LVV) dhe **Enver Kryeziu** (PAI), kanë marrë **0 pikë**, duke pasur një mungesë totale të pjesëmarrjes në seanca dhe diskutime.

Kjo mungesë e angazhimit është një shqetësim për Kuvendin e Komunës së Lipjanit, pasi ky organ është i ngarkuar me detyrën e rëndësishme të përfaqësimit të interesave të qytetarëve dhe duhet të ofrojë një platformë për diskutime dhe vendimmarrje që ndihmojnë në zhvillimin e komunitetit. Mungesa e

pjesëmarrjes nga këta individë vë në pikëpyetje aftësinë e Kuvendit për të ofruar përfaqësim të plotë dhe efektiv.

Përfundime dhe Rekomandime

Dinamika e punës së Kuvendit të Komunës së Lipjanit pasqyron një ndarje të qartë mes kuvendarëve aktivë dhe atyre pasivë. Për ata që janë aktivë, puna e tyre është një shembull i përkushtimit dhe angazhimit ndaj qytetarëve të Lipjanit. Ata kanë kontribuar në diskutime, kanë ngritur çështje të rëndësishme dhe kanë siguruar që zëri i qytetarëve të dëgjohet në Kuvend.

Megjithatë, për kuvendarët që janë pasivë, është e nevojshme që të merren masa për të rritur angazhimin e tyre dhe për të siguruar që ata të përmbushin përgjegjësitë që kanë marrë si përfaqësues të zgjedhur. Kuvendi duhet të ofrojë mundësi më të mira për pjesëmarrjen dhe të sigurojë një atmosferë ku çdo kuvendar mund të kontribuoni në mënyrë aktive dhe efektive për të mirën e qytetarëve.

Përfundimisht, kjo analizë tregon se, për të përmirësuar funksionimin e Kuvendit të Komunës së Lipjanit, është e nevojshme të inkurajohen më shumë debatet dhe angazhimi aktiv i të gjithë kuvendarëve, pa marrë parasysh grupin politik nga i përkasin. Angazhimi i plotë i të gjithë përfaqësuesve është thelbësor për ndërtimin e një Kuvendi që ka për qëllim përmirësimin e kushteve të jetesës për qytetarët e Lipjanit.

Tabela 2: Renditja e Kuvendareve bazuar në angazhimet e tyre nga seanca plenare 26-31 e Kuvendit të Lipjanit

	Kuvendari	Subjekti politikë	pikët		Kuvendari	Subjekti politikë	pikët
1	Arsim Jashari	PDK	155	16	Gazmend Qerkini	LDK	17
2	Lumturije Bytyqi Hasani	PDK	104	17	Ganimete Qeriqi	PDK	17
3	Rinor Murati	LDK	101	18	Gentiane Hoxhaj	LDK	16
4	Alban Salihu	LVV	91	19	Bashkim Budakova	AAK	15
5	Shahadije Dragacina	LVV	87	20	Shkelzim Olluri	LDK	8
6	Lulzim Rustemi	PDK	86	21	Fadil Sopa	LDK	4
7	Egzona Bytyqi	PDK	75	22	Majlinda Sylejmani	LDK	0
8	Ardit Cani	PDK	51	23	Venhar Agushi	LDK	0
9	Albiona Tasholli	LDK	40	24	Xhyla Dedushaj Rexhepi	LDK	0
10	Nexhmedin Lekiqi	LDK	37	25	Sami Bytyqi	LDK	0
11	Fadil Spahiu	LVV	29	26	Fitim Shala	LDK	0
12	Herolind Kozhani	PDK	28	27	Xhyzide Rustemi	LDK	0
13	Besiana Sylja	LVV	28	28	Fatmir Fetahu	LVV	0
14	Fitim Meziu	LVV	27	29	Enver Kryeziu	PAI	0
15	Armend Grajcevc	LDK	21	30	Shefki Bytyqi	LDK	-1

LISTA E RREGULLOREVE DHE PLANEVE TË SHQYRTUARA NGA KUVENDI KOMUNAL TË VITIT 2025:

- Nuk ka

LISTA E RAPORTEVE TË SHQYRTUARA NGA KUVENDI KOMUNAL TË VITIT 2023:

- Raporti i shpenzimeve dhe të hyrave Janar-Dhjetor 2025.
- Raporti Janar - Dhjetor 2025 i punës së Zyrës së Kryetarit dhe Drejtorateve komunale.
- Informatë për punën e KKSB-së në Lipjan për vitin 2025.
- Raporti i shpenzimeve dhe të hyrave Janar – Mars 2025.

LISTA E VENDIMEVE KOMUNALE TË MIRATUAR GJATË PERIUDHËS JANAR - QERSHOR 2025:

- Vendim për miratimin e ofertës së përzgjedhur nga komisioni vlerësues për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës në Zonën Kadastrale Babush i Muhaxherëve P-71409059-00559-10.
- Vendim për miratimin e ofertës së përzgjedhur nga komisioni vlerësues për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës në Zonën Kadastrale Babush i Muhaxherëve P-71409059-00559-11.
- Vendim për miratimin e ofertës së përzgjedhur nga komisioni vlerësues për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës në Zonën Kadastrale Babush i Muhaxherëve P-71409059-00559-12.
- Vendim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës në Zonën Kadastrale Konjuh.
- Vendim për lirim nga pagesa e borxheve të qirasë joprofitabile të përfituesve të banimit social.
- Vendim për dhënien në shfrytëzim të tokës-pasuri shoqërore për vendosjen e trafostacionit të ri të tipit shtyllë betoni në Sillovi.
- Vendim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronave të paluajtshme-lokaleve afariste të Komunës në Zonat Kadastrale Lipjan dhe Magurë.
- Vendim për formimin e Komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronave të paluajtshme të Komunës-lokaleve afariste në Zonat Kadastrale Lipjan dhe Magurë.
- Vendim për ndarjen e mjeteve financiare për iniciativën për zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës – IADK.
- Vendim për dhënien e pëlqimit për ndarjen e mjeteve financiare Shoqatës Sindikale të Administratës Komunale.

- Vendim për zëvendësimin e anëtares të Komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të Komunës në ZK Konjuh.
- Vendim për miratimin e Planit të veprimit komunal për strehim familjar për Komunën e Lipjanit.
- Vendim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të Komunës.
- Vendim për formimin e Komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së të paluajtshme të Komunës në ZK Babush i Muhaxherëve.
- Vendim për ndarjen e mjeteve financiare për Kosova -Women 4 Women.
- Vendim për formimin e Komisionit përzgjedhës Ad.hoc për përzgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve në institucionet publike edukativo arsimore të Komunës së Lipjanit.
- Vendim për dhënien e pëlqimit për ndarjen e mjeteve financiare për fermerë për subvencionim të qumështit.
- Vendim për ritjen e buxhetit të Komunës së Lipjanit nga tejkalimi i të hyrave vetanake për vitin 2025.
- Vendim mbi dhënjen e pëlqimit për bartjen e të hyrave vetanake të Komunës së Lipjanit të vitit 2023 dhe 2025 në vitin 2025.
- Vendim për miratimin e Strategjisë për zhvillimin dhe fuqizimin e rinisë në Komunën e Lipjanit (2025-2030) dhe Planit të Veprimit Rinor Lokal (2025-2027).
- Vendim për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Shtëpisë Muze të veteranëve të UÇK-së në Zonën Kadastrale Krojmir.
- Vendim për caktimin e lokacionit për varreza në fshatin Qylagë.
- Vendim për miratimin e ofertës së përzgjedhur nga Komisioni Vlerësues për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës ZK-Grackë e Vjetër.
- Vendim për ndarjen e mjeteve financiare për subvencionimin e aktiviteteve të Kryetarëve të Këshillave të fshatrave dhe lagjeve urbane të Komunës së Lipjanit.
- Vendim për ndarjen e mjeteve financiare për Islamik Relief Worldwide- zyra në Kosovë (IRW).
- Vendim për furnizimin e përkohshëm me derivate të automjeteve të njësisë operative "KRM" Pastrimi në Lipjan.
- Vendim për plotësimin dhe ndryshimin e vendimit 1Nr.464-47684 të datës 29.09.2015 për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronave të paluajtshme të komunës të tokës bujqësore.
- Vendim mbi aprovimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore 2026-2028.
- Vendim për ndryshimin e emërimit të Shkollës së Mesme Profesionale "Adem Gllavica"
- Vendim për formimin e Komisionit përzgjedhës ad.hoc për përzgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve në institucionet publike edukativo arsimore të Komunës së Lipjanit.
- Vendim për anulimin e Vendimit 15nr.352/05-27004 i datës 29.05.2025 për caktimin e lokacionit për varreza në fshatin Qylagë.

Pjesëmarrja në diskutime gjatë seancave

Në gjysmën e parë të vitit 2025, dinamika e diskutimeve në seancat e Kuvendit të Komunës së Lipjanit ka treguar qartë se partitë opozitare kanë qenë më të zëshmet dhe më të angazhuarat në adresimin e çështjeve të ndryshme me rëndësi për qytetarët. Ky trend i vazhdueshëm në Lipjan thekson rolin kritik që opozita luan në nxitjen e debatit dhe në mbajtjen e ekzekutivit në llogari.

Partia Demokratike e Kosovës (PDK) ka qenë subjekti më aktiv në diskutimet gjatë seancave të Kuvendit, duke realizuar **38 diskutime**, ose **43.18%** të totalit të tyre. PDK ka shfaqur një prani të fuqishme në të gjitha seancat e monitoruara, duke ngritur çështje që lidhen me përmirësimin e shërbimeve publike, menaxhimin e financave komunale dhe transparencën e proceseve vendimmarrëse.

Pjesëmarrja e PDK-së ka shërbyer jo vetëm për të shtyrë përpara agjendën e saj politike, por edhe për të hapur diskutime mbi temat që prekin drejtpërdrejt jetën e qytetarëve të Lipjanit. Kjo ka ndihmuar që në shumë raste Kuvendi të fokusohet në prioritetet e komunitetit dhe të kërkojë përgjigje të qarta nga ekzekutivi.

Lëvizja Vetëvendosje (LVV) është radhitur e dyta për nga angazhimi në diskutime, me **27 diskutime** që përbëjnë **30.68%** të totalit. LVV ka kontribuar ndjeshëm në debatet mbi politikat sociale, zhvillimin e infrastrukturës lokale dhe ka insistuar në respektimin e ligjit dhe procedurave administrative.

Diskusimet e LVV-së shpesh kanë pasur karakter kritik dhe kanë nxitur ekzekutivin të japë më shumë shpjegime mbi vendimet e marra dhe projektet në zbatim. Ky lloj angazhimi e bën LVV-në një faktor të rëndësishëm në nxitjen e transparencës në nivel lokal.

Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), ndonëse në pushtet në komunë, ka pasur një aktivitet më të moderuar në diskutime, duke regjistruar **23 diskutime**, ose **26.14%** të totalit. Angazhimi i LDK-së ka qenë kryesisht teknik dhe procedural, shpeshherë duke mbrojtur punën e ekzekutivit dhe duke dhënë shpjegime shtesë për projektet e ndërmarra.

Megjithatë, pjesëmarrja e LDK-së në diskutime ka qenë e rëndësishme për të balancuar debatet dhe për të shpjeguar strategjitë e qeverisjes lokale, duke ofruar një perspektivë të brendshme mbi planet dhe prioritetet e komunës.

Përkundër pritjeve që të gjitha subjektet politike të përfaqësuara në Kuvend të kontribuojnë në diskutime dhe të ofrojnë qasjet e tyre mbi sfidat e komunës, **Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK)** dhe **Partia e Ashkalinjëve për Integrim (PAI)** nuk kanë pasur asnjë diskutim gjatë kësaj periudhe, duke rezultuar në **0%** pjesëmarrje në debatet e seancave.

Ky pasivitet i plotë i AAK-së dhe PAI-së lë një boshllëk të dukshëm në pluralizmin e mendimeve brenda Kuvendit dhe kufizon gamën e temave që mund të trajtohen nga këndvështrime të ndryshme politike.

Tabela 3: Pjesëmarrja e subjekteve politike gjatë seancave plenare në Kuvendin e Komunës së Lipjanit

	Propozim për rend dite			Pjesëmarrja në diskutime gjatë seancave			Pjesëmarrja në Diskutime në emër të grupit të anëtarëve			Inicimi i çështjeve			Pyetjet parlamentare			Mungesa në seanca		
Subjekti politik	Disk	%		Disk.	%		Disk.	%		Inic.	%		Pyet	%		Mung		
LDK	23	26.14	%	8	42.11	%	23	22.33	%	6	19.35	%	2	40.00	%	23	26.14	%
PDK	38	43.18	%	11	57.89	%	57	55.34	%	14	45.16	%	2	40.00	%	38	43.18	%
LVV	27	30.68	%	0	0.00	%	20	19.42	%	11	35.48	%	1	20.00	%	27	30.68	%
AAK	0	0.00	%	0	0.00	%	3	2.91	%	0	0.00	%	0	0.00	%	0	0.00	%
PAI	0	0.00	%	0	0.00	%	0	0.00	%	0	0.00	%	0	0.00	%	0	0.00	%

Pjesëmarrja në diskutime në emër të subjekteve politike në Kuvendin e Lipjanit: Kush ishin më aktivët në gjysmën e parë të vitit 2025?

Gjatë gjysmës së parë të vitit 2025, pjesëmarrja në diskutime në **emër të subjektit politik** në Kuvendin e Komunës së Lipjanit ka treguar një tablo të qartë të angazhimit të partive politike në mbrojtjen e qëndrimeve dhe interesave të tyre. Kjo formë diskutimi ka një rëndësi të veçantë, pasi përfaqëson qëndrimin zyrtar të subjekteve politike përballë çështjeve që trajtohen në seanca dhe përçon mesazhe të qarta politike për qytetarët.

Partia Demokratike e Kosovës (PDK) ka qenë dukshëm subjekti më aktiv në diskutimet e bëra në emër të subjektit politik, me **11 diskutime**, që përbëjnë **57.89%** të të gjitha diskutimeve të këtij lloji. Përmes këtyre diskutimeve, PDK ka shpalosur vazhdimisht qëndrimet e saj politike lidhur me qeverisjen komunale, transparencën, menaxhimin e financave dhe projektet kapitale që prekin qytetarët e Lipjanit.

Diskutimet e PDK-së shpesh kanë pasur karakter kritik ndaj ekzekutivit komunal, duke ngritur shqetësime për mënyrën e realizimit të projekteve, shpërndarjen e buxhetit dhe përfshirjen e qytetarëve në vendimmarrje. Ky angazhim i lartë e bën PDK-në një faktor të rëndësishëm në mbajtjen e balancës dhe kontrollit demokratik mbi qeverisjen lokale.

Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) ka qenë subjekti i dytë më aktiv në diskutime të mbajtura në emër të subjektit politik, me **8 diskutime**, që përfaqësojnë **42.11%** të totalit. LDK, si subjekt që drejton ekzekutivin komunal, ka shfrytëzuar këto diskutime kryesisht për të sqaruar vendimet e qeverisjes, për të mbrojtur projektet e ndërmarra dhe për të promovuar politikën e saj zhvillimore.

Diskutimet në emër të LDK-së kanë synuar të japin përgjigje ndaj kritikave të opozitës dhe të theksojnë rezultatet e punës së ekzekutivit, duke u përqendruar shpesh në projektet infrastrukturore, përmirësimin e shërbimeve komunale dhe investimet në arsim e shëndetësi.

Në dallim nga PDK dhe LDK, tre subjektet tjera të përfaqësuara në Kuvendin e Lipjanit – **Lëvizja Vetëvendosje (LVV)**, **Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK)** dhe **Partia e Ashkalinjëve për Integrim (PAI)** – nuk kanë realizuar asnjë diskutim në emër të subjektit politik gjatë kësaj periudhe gjashtëmujore.

Kjo mungesë e plotë e zërit politik të këtyre subjekteve në Kuvend përmes diskutimeve të drejtpërdrejta në emër të partisë lë një boshllëk të dukshëm në pluralizmin e debatit politik lokal. Ajo gjithashtu i privon qytetarët nga mundësia për të dëgjuar qëndrimet dhe platformat e këtyre subjekteve mbi çështjet me interes të drejtpërdrejtë për komunitetin.




Tabela 4: Pjesëmarrja e Kuvendareve gjatë seancave plenare në Kuvendin e Komunës së Lipjanit

KOMUNA E LIPJANIT		Propozim për rend dite	Pjesëmarrja në diskutime gjatë seancave	Pjesëmarrja në Diskutime në emër të grupit të anëtarëve	Inicimi i çështjeve	Amandamentimi i legjislacionit	Inicimi i rregulloreve	Pyetjet parlamentare	Mungesa në seanca	Gjuha jo parlamentare	Gjithsej pike
Deputetët	Subjekti politik										
Nexhmedin Lekiqi	LDK	0	12	0	25	0	0	0	0	0	37
Majlinda Sylejmani	LDK	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Shefki Bytyqi	LDK	0	0	0	0	0	0	0	-1	0	-1
Gazmend Qerkini	LDK	0	12	0	5	0	0	0	0	0	17
Shkelzim Olluri	LDK	0	8	0	0	0	0	0	0	0	8
Albiona Tasholli	LDK	0	8	2	20	0	0	10	0	0	40
Fadil Sopu	LDK	0	4	0	0	0	0	0	0	0	4
Gentiane Hoxhaj	LDK	0	8	3	0	0	0	5	0	0	16
Venhar Agushi	LDK	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Xhyla Dedushaj Rexhepi	LDK	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Sami Bytyqi	LDK	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Fitim Shala	LDK	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Xhyzide Rustemi	LDK	0	0	1	0	0	0	0	-1	0	0
Rinor Murati	LDK	0	36	0	60	0	0	5	0	0	101
Armend Grajcevc	LDK	0	4	2	5	0	0	10	0	0	21
Lulzim Rustemi	PDK	0	36	0	25	0	0	25	0	0	86
Herolind Kozhani	PDK	0	12	1	15	0	0	0	0	0	28
Ardit Cani	PDK	0	0	1	40	0	0	10	0	0	51
Arsim Jashari	PDK	0	52	8	75	0	0	20	0	0	155
Egzona Bytyqi	PDK	0	16	1	45	0	0	15	-2	0	75
Lumturije Bytyqi Hasani	PDK	0	24	0	80	0	0	0	0	0	104
Ganimete Qeriqi	PDK	0	12	0	5	0	0	0	0	0	17
Alban Salihu	LVV	0	56	0	25	0	0	10	0	0	91
Fitim Meziu	LVV	0	12	0	0	0	0	15	0	0	27
Fadil Spahiu	LVV	0	0	0	25	0	0	5	-1	0	29
Fatmir Fetahu	LVV	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Shahadije Dragacina	LVV	0	32	0	30	0	0	25	0	0	87
Besiana Sylu	LVV	0	8	0	20	0	0	0	0	0	28
Bashkim Budakova	AAK	0	0	0	15	0	0	0	0	0	15
Enver Kryeziu	PAI	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0

PYETJE PARLAMENTARE

Pyetjet parlamentare janë një ndër mjetet më të rëndësishme të punës së kuvendarëve për të mbajtur ekzekutivin përgjegjës dhe për të adresuar çështjet që prekin qytetarët. Ato shërbejnë si një mekanizëm i drejtpërdrejtë i kontrollit dhe transparencës, duke detyruar ekzekutivin të japë shpjegime dhe të sqarojë vendimet e tij. Monitorimi i YAHR për gjysmën e parë të vitit 2025 tregon një angazhim të ndryshëm të subjekteve politike në këtë drejtim, me disa që kanë shfaqur një aktivitet të lartë dhe disa të tjera që kanë munguar plotësisht.

Partia Demokratike e Kosovës (PDK) ka qenë subjekti më aktiv në parashtrimin e pyetjeve parlamentare ndaj ekzekutivit, duke adresuar gjithsej **14 pyetje**, që përfaqësojnë **45.16%** të totalit të pyetjeve të bëra gjatë kësaj periudhe. Përmes këtyre pyetjeve, PDK ka synuar të nxjerrë në pah çështje të rëndësishme që lidhen me menaxhimin financiar, zbatimin e projekteve kapitale, ndarjen e resurseve dhe transparencën në procedurat tenderuese.

Ky aktivitet i lartë tregon përkushtimin e PDK-së për të mbajtur një presion konstant mbi ekzekutivin komunal dhe për të siguruar që interesat e qytetarëve të Lipjanit të mbrohen me seriozitet. Shpeshherë këto pyetje kanë shërbyer edhe për të hapur diskutime më të gjera brenda Kuvendit mbi temat që prekin jetën e përditshme të komunitetit.

Lëvizja Vetëvendosje (LVV) është radhitur e dyta për nga numri i pyetjeve të parashtruara, me **11 pyetje**, ose **35.48%** të totalit. LVV ka përdorur pyetjet parlamentare për të sfiduar ekzekutivin mbi çështje të planifikimit urban, menaxhimit të shërbimeve publike dhe respektimit të ligjshmërisë në vendimarrjet komunale.

Këto pyetje kanë ndihmuar që të mbahen të hapura temat që ndonjëherë mund të anashkalohen nga agjenda zyrtare, duke rritur transparencën dhe duke bërë që ekzekutivi të japë llogari për vendimet e tij në mënyrë publike.

Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), që udhëheq ekzekutivin komunal, ka bërë **6 pyetje parlamentare**, që përbëjnë **19.35%** të totalit. Pyetjet e LDK-së kanë qenë kryesisht me karakter sqarues ose janë përdorur për të theksuar arsyetimin e disa vendimeve të ekzekutivit, duke treguar më shumë një qasje të balancuar mes kontrollit të brendshëm dhe mbështetjes ndaj qeverisjes lokale.


Ky aktivitet më i ulët në krahasim me opozitën është i zakonshëm për subjektet që udhëheqin ekzekutivin, por gjithsesi pjesëmarrja në këtë mekanizëm është tregues i përgjegjësisë dhe i vullnetit për t'iu përgjigjur edhe shqetësimeve të brendshme.

Për dallim nga PDK, LVV dhe LDK, partitë **AAK** dhe **PAI** nuk kanë parashtruar **asnjë pyetje parlamentare** gjatë kësaj periudhe. Kjo mungesë e plotë aktiviteti në njërin nga mekanizmat më të rëndësishëm të mbikëqyrjes së punës së ekzekutivit lë një boshllëk të dukshëm në dinamikën demokratike të Kuvendit.

Qytetarët presin që të gjitha subjektet politike të jenë të zëshme dhe të interesuara për të mbajtur ekzekutivin në llogari, ndaj ky pasivitet i AAK-së dhe PAI-së tregon nevojën për më shumë angazhim nga ana e tyre në të ardhmen.

Tabela 5: Pjesëmarrja e subjekteve politike në pyetjeve parlamentare në Kuvendin e Komunës së Lipjanit

Subjekti politik	Pyetjet parlamentare		
	Pyetje	%	
LIDHJA DEMOKRATIKE E KOSOVËS	6	19.35	%
PARTIA DEMOKRATIKE E KOSOVËS	14	45.16	%
LËVIZJA VETËVENDOSJE	11	35.48	%
ALEANCA PËR ARDHMERINË E KOSOVËS	0	0.00	%
PARTIA ASHKALINJVE PËR INTERGRIM	0	0.00	



INICIMI I ÇËSHTJEVE

Inicimi i çështjeve në Kuvendin e Komunës së Lipjanit është një prej treguesve më të qartë të angazhimit të subjekteve politike për të adresuar problemet konkrete të qytetarëve. Ai pasqyron vullnetin e kuvendarëve dhe të partive të tyre për të shtyrë përpara çështje që kanë rëndësi lokale, si dhe për të siguruar që këto tema të diskutohen publikisht e të marrin vëmendjen e ekzekutivit.

Monitorimi i bërë nga **YHR** gjatë gjysmës së parë të vitit 2025 ka evidentuar dallime të qarta mes subjekteve politike në këtë aspekt.

Partia Demokratike e Kosovës (PDK) ka qenë padyshim subjekti më aktiv në iniciimin e çështjeve në Kuvendin e Komunës së Lipjanit. Gjatë periudhës janar-qershor 2025, PDK ka ngritur gjithsej **57 çështje**, që përfaqësojnë një pjesë dominuese prej **55.34%** të të gjitha çështjeve të inicuar nga subjektet politike.

Kjo shifër e lartë tregon një angazhim të fuqishëm të PDK-së për të nxjerrë në pah problematika që prekin jetën e përditshme të qytetarëve të Lipjanit, si infrastruktura, shërbimet komunale, çështjet sociale dhe menaxhimi i resurseve publike. Përmes iniciimit të këtyre çështjeve, PDK ka dëshmuar se është në krye të përpjekjeve për të vendosur prioritetet e qytetarëve në rend dite dhe për të nxitur ekzekutivin të marrë masa konkrete.

Edhe pse **LDK** drejton ekzekutivin në komunë, ajo ka qenë e dyta për nga numri i çështjeve të inicuar në Kuvend, me **23 çështje**, që përbëjnë **22.33%** të totalit. Ky aktivitet është tregues i një debati të brendshëm demokratik brenda Kuvendit, ku edhe subjektet që janë në pushtet nuk kanë hezitur të ngrejë çështje që kërkojnë vëmendje dhe zgjidhje.

Iniciativat e LDK-së kanë pasur shpesh karakter teknik dhe zhvillimor, të lidhura me projektet e komunës dhe optimizimin e shërbimeve për qytetarët. Ky lloj angazhimi e mban gjallë diskutimin institucional dhe i ofron Kuvendit një platformë të vlefshme për të përcaktuar prioritetet lokale.

Lëvizja Vetëvendosje (LVV) ka ngritur gjithsej **20 çështje**, ose **19.42%** të totalit, duke konfirmuar rolin e saj si një opozitë konstruktive në Kuvendin e Lipjanit. Iniciativat e LVV-së kanë pasur në fokus çështje sociale, ndarjen e drejtë të buxhetit dhe qeverisjen transparente.

Përmes këtyre çështjeve të inicuar, LVV ka synuar të vendosë ekzekutivin përballë përgjegjësisë të tij dhe të sigurojë që komuniteti të marrë shërbimet dhe mbështetjen që meriton. Ky angazhim e bën LVV-në një pjesë të rëndësishme të dialogut politik në komunë.


Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) ka kontribuar më pak në këtë proces, duke inicuar vetëm **3 çështje**, që përfaqësojnë **2.91%** të totalit. Megjithatë, edhe pse në numër të vogël, këto iniciativa kanë shtuar larmishmërinë e temave të diskutuara në Kuvend dhe kanë ndihmuar që të mbahen të hapura disa çështje të rëndësishme për komunitetin.

Ndryshe nga subjektet e tjera, **Partia e Ashkalinjëve për Integrim (PAI)** nuk ka ngritur asnjë çështje gjatë kësaj periudhe gjashtëmuajore, duke pasur **0 çështje të inicuar**, përkatësisht **0.00%** të totalit. Kjo

mungesë totale e angazhimit e lë këtë subjekt politik jashtë procesit të adresimit të problemeve të komunitetit në mënyrë institucionale, dhe tregon nevojën për rritjen e pjesëmarrjes së tij në të ardhmen.

Tabela 6: Pjesëmarrja e subjekteve politike në Inicimi i çështjeve në Kuvendin e Komunës së Lipjanit

Subjekti politik	Inicimi i çështjeve		
	Inicime	%	
LIDHJA DEMOKRATIKE E KOSOVËS	23	22.33	%
PARTIA DEMOKRATIKE E KOSOVËS	57	55.34	%
LËVIZJA VETËVENDOSJE	20	19.42	%
ALEANCA PËR ARDHMERINË E KOSOVËS	3	2.91	%
PARTIA ASHKALINJVE PËR INTERGRIM	0	0.00	%



BURIMET:

1. Intervista të drejtpërdrejta me qytetarë, pjesëtarë të shoqërisë civile dhe media lokale. 2025.
2. Monitorimi i drejtpërdrejtë i aktiviteteve komunale nga zyrtaret e YAHR-it, r2025
3. <https://kk.rks-gov.net/lipjan/>
4. Raportet mujore të drejtorive komunale të Komunës së Lipjanit, ..
5. Komunikatat për media të YAHR-it 2025.
6. Ekstraktet nga mbledhjet e Kuvendit Komunal të Lipjanit 2025,
7. <http://kk.rks-gov.net/Lipjan/>
8. <https://www.youtube.com/channel/UCmDXxB6d1n6gXGtEiowljQQ>

—

2025